



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2018/4 prot

Datë 01.11.2021

**V E N D I M**  
**Nr. 832/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.11.2021, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:**

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “BDB Group/Besnik Meçi” PF nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, me Marrëveshje kuadër*”, me Nr. REF-05122-09-13-2021, me objekt “*Mirëmbajtja e automjeteve*”, me fond limit 12,237,670 (dymbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.09.2021 nga autoriteti kontraktor, Albanian Gas Services Company SH.A.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

**Ankimues:**

“BDB Group/Besnik Meçi” PF  
Autostrada Tr-Dr, km 5, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Albanian Gas Services Company SH.A.  
Rruga e Kosovarëve, Pallati Ndërpro shpk, Tiranë

**Baza Ligjore:**

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Ankimuesi ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 14.09.2021, është publikuar në SPE procedura e prokurimit “Procedurë e hapur, me Marrëveshje kuadër”, me Nr. REF-05122-09-13-2021, me objekt “Mirëmbajtja e automjeteve”, me fond limit 12,237,670 (dymbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.09.2021 nga autoriteti kontraktor, Albanian Gas Services Company SH.A.

II.2. Në datën 14.10.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës mbi rezultatin e vlerësimit nga KVO të ofertave të paraqitura.

II.3. Në datën 15.10.2021, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit.

II.4. Në datën 21.10.2021 operatori ekonomik “BDB Group/Besnik Meçi” PF ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik me datë 20.10.2021, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin e publikimit me nr. 2018/2 prot., datë 21.10.2021, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “BDB Group/Besnik Meçi” PF.

II.6. Nëpërmjet shkresës nr. 114/8 prot., datë 26.10.2021, protokolluar me tonën respektivisht me nr. 2018/3 prot., datë 28.10.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni përkatës i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se, ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “BDB Group/Besnik Meçi” PF dhe me shkresën nr.

114/7 prot., datë 25.10.2021, e ka njoftuar atë se ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës. Konkretisht, *ankimuesi “Besnik Meçi” PF pretendon se AGS SHA e ka skualifikuar në mënyrë të padrejtë duke argumentuar mbi shkeljet e pretenduara si më poshtë:*

*1. Lidhur me kriterin se operatori ekonomik duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 4 punonjës të profileve motorrist, xhenerik, elektroaut dhe bojaxhi, ankuesi sqaron se ka rinovuar kontratat e punës me punonjësit e tij më datë 13.09.2021 deri më 13.09.2023, pasi kontrata aktuale ishte e vlefshme deri më datën 01.01.2023 dhe nuk mbulonte afatin prej 9 muajsh deri në përfundimin e afatit të marrëveshjes kuadër. Këta punonjës janë të deklaruar në listpagesën Esig 025a prej vitesh dhe nuk janë punonjës të rinj.*

*Në pikën 2.2.5 të shtojcës 8, AK ka kërkuar shprehimisht se: Operatori ekonomik për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 4 (katër) punonjës sipas profileve si më poshtë:*

- 1 (një) motorrist
- 1 (një) xhenerikë
- 1 (një) elektroaut
- 1 (një) bojaxhi,

*Operatori ekonomik duhet ta provojë disponimin e personelit teknik me profilet e punës të cituara më sipër, nëpërmjet këtij dokumentacioni:*

*Kontratat individuale të punës, si dhe listëpagesat e punonjësve (E-Sig 025) të deklaruar në organet tatimore për muajin gusht 2021, ku të jenë të deklaruar këta punonjës sipas profileve të kërkuara si më sipër. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DT. Ndërsa dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE që shpallet fitues. Për plotësimin e këtij kriteri, ankuesi ka dorëzuar Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9, ku në seksionin B ka deklaruar se disponon punonjësit e nevojshëm sipas profileve inxhinier mekanik, motorris, xhenerik, elektroaut, si dhe drejtues teknik. Për sa më sipër, kërkesa për pikën 2.2.5, ku është kërkuar vetëm dorëzimi i vetëdeklarimit nga ana e operatorëve ekonomikë është plotësuar nga ankuesi “Besnik Meçi” PF, ndaj pretendimi i tij qëndron”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës së tij, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Referuar shkresës nr. 114/7 prot., datë 25.10.2021 të autoritetit kontraktor rezulton se, ky i fundit ka pranuar pjesërisht ankesën duke pranuar pretendimet lidhur me pretendimet për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik ankimues “BDB Group/Besnik Meçi” PF.

II.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës për procedurën e prokurimit me “Procedurë e hapur, me Marrëveshje kuadër”, me Nr. REF-05122-09-13-2021, me objekt “Mirëmbajtja e automjeteve”, me fond limit 12,237,670 (dymbëdhjetë milion e dyqind e tridhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 29.09.2021 nga autoriteti kontraktor, Albanian Gas Services Company SH.A.
2. Të vazhdojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.
3. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**

**Fiorent Zguro**

**Anëtar**

**Anila Malaj**

**Anëtar**

**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**

**Jonaid Myzyri**